



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**QENDRA KOMUNITARE PËR PERSONA ME AFTESI TË KUFIZUARA**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Mobilimi i Qendrës Komunitare Per Persona me Aftësi të Kufizuara

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

FPP: 39130000-2 - Mobilje për zyra

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

6.400.830.(gjashtemilion e katerqind mije e teteqind e tridhete lek pa tvsh

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

**Numri i referencës së procedurës /Lotit: **REF-65925-04-13-2023****

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Qendra Komunitare Pwr Persona me Aftwsi tw Kufizuara Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

### KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;  
nuk është në proces falimentimi (status aktiv);  
nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;  
ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;  
nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;  
dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;  
Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.  
Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;  
Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;  
gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;  
Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.  
operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimene lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhimme shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, nenit 26 dhe nenit 40 pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime. Në neni 26 të kësaj VKM shprehimisht thuhet se: "...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...".

#### KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 29 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilin shprehimisht citohet se: "1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike".

*Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi: Kjo kërkesë është pjesë e setit të dokumentave standarte të tenderit për procedurë prokurimit të sipërcituar.

*Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

$6.400.300 \times 0.02 = 128.006$  (njqind e njezet e tete mijë e gjashte) lekë pa t.v.sh

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenin 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...";

"...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...".

*Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, nenit 26 dhe nenit 40 pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime. Në neni 26 të kësaj VKM shprehimisht thuhet se: "...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...".

Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ky kriter plotësohet me përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 dhe nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP Nr.162/2020, në nenin 25 dhe nenin 40 pika 5 dhe 7, të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kriterë synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron, për 3 (tre) vitet e fundit financiar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, përkatësisht fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, mbështetur në nenin 77, pika 3, e LPP, si edhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar referohet në llojin e procedurës së prokurimit, kushtëzuar nga fondi limit, i cili është nën kufirin e ulët monetar. (Neni 43, pika 2, gërma "c" e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar). Duke qënë se akti nënligjor njih kufirin maksimal të vlerës së kërkuar të xhiros vjetore, autoriteti kontraktor synon që me kërkesën për këtë kriter të marrë garanci që një kandidat ose ofertues ka kapacitete të plota financiare.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat ligjore për prokurimin, neni 55 i VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar si dhe në Udhëzimin Nr. 7, datë 10.1.2017 "Për disashtesa në Udhëzimin Nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”, të ndryshuar, ku citohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Sa më lartpërmendur, duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerëne xhiros që mund të kërkohet, autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën e kërkuar të xhiros (40% të fondit limit) brenda këtij marzhi.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato ishërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhetë mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 (tre) vitet e fundit financiar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të çertifikuara nga administrata tatimore dhe të shoqëruara me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjetaktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhenenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht nenit 9, të Ligjit Nr. 25/2018, “Përkontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Operatorët duhet të paraqesin akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Përauditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato ishërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhetë mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 pika 4 dhe nenin 55 pika 4/b, e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 88 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, pranohet që “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme, si kriter kualifikimi, garanton autoritetin se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Referuar objektit të procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktor gjykon të kërkojë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca e përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën, duke kërkuar kështu dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme në vlerën prej jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që operatorit ekonomik ofertes mund të realizoj kontratën objekt prokurimi.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se është prodhues i mobiljeve të drurit duhet të ketë të Dokumentat Standarde të Tenderit 10 punësuar për periudhën Janar – Mars 2023, një staf punonjësish prej minimalisht 15 persona, nga të cilët të paktën 1 (një) punonjës duhet të jetë i punësuar si Inxhinier Druri. Për stafin e punonjësve ofertes duhet të paraqesë: - Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore; - Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Janar – Mars 2023. - Diplomë dhe kontratë pune e vlefshme e punonjësit Inxhinier Druri.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllogaritur duke gjykuar si më poshtë:

Në vendosjen e numrit minimal të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si grafikui lëvrimin të mallrave, transporti, montimi, zhvendosja dhe sistemimi i tyre në ambientet e AK, riparimi dhe çdo proces tjetër përgjatë periudhës së garancisë. AK nuk ka përcaktuar detyra të veçanta për punonjësit duke ia lënë organizimin e tyre kontraktorit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për AK se operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, shoqëruar me listëpagesat është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, si dhe përvojën e tyre, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat

themelore të kualifikimit, përpqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangiene informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për të paktën 4 (katër) punonjës, është një përputhje me volumin e kontratës, natyrën dhe furnizim e mallrave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë fuqinë punëtore që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Operatori ekonomik pjesmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë garancie të mallrave që kërkohen të prokurohen, nëpërmjet së cilës duhet të marrë përsipër dhe të garantojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit, për njëperiudhë jo më pak se 2 vjet nga koha e marrjes në dorëzim të artikujve nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të nenin 40, pika 3 dhe 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dakortësinë për të përmbushur kontratën konform kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

*“...Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve...”*

Operatori ekonomik pjesmarrës, duhet të paraqesë:

Certifikatë ISO 9001: 2015, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, ose ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me objektin e prokurimit.

Certifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomike, sipas natyrës së shërbimeve që marrin përsipër.

Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të LPP Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 44 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku ndër të tjera citohet se: *“Autoriteti Kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*.

Operatori ekonomik pjesmarrës në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga një mostër, vetëm për artikujt e mëposhtëm (sipas përcaktimeve në Shtojcën 5):

- Artikulli – Tavoline zyre
- Artikulli -- Tavoline te ulta per femije
- Artikulli - Karrike e lëvizshme me rrota për punonjës.
- Artikulli - Karrike per femije
- Artikulli - Raftë per zyra

Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbaj: “emri i artikullit”, “datë zhvillimit të tenderit”, “emrin e prodhuesit/ofertuesit”, “nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik”.

Mosparaqitja e mostrave, është kusht skualifikues.

(Dorëzimi i mostrave do të bëhet me procesverbal)

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 40 pika 6/a e VKM Nr. 285/2021, "Për Miratmin e Rregullave të Prokurimit", me ndryshime, ku shprehimisht thuhet se:

Autoriteti kontraktor mund t'ua kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

*"...mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të Autoritetit Kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit..."*

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Për efekt të verifikimit të gjendjes gjyqësore, operatorët ekonomikë së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të sjellin edhe fotokopjen e çertifikatës personale të administratorit dhe të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti) të deklaruar në formularin evetëdeklarimit.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e certifikatës personale të administratorit të shoqërisë ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e çertifikuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur për të verifikuar nëse personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP. Verifikimi i gjendjes gjyqësore kryhet sipas procedurës të bazuar në njoftimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 1155 prot., datë 01.02.2019 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr. 1001/1 prot., datë 01.02.2019).

Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor do t'ia kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si edhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacionin fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paraqitur.

Ky kriter është bazuar në Njoftimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 1155 Prot., datë 01.02.2019 dhe Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 Prot., datë 01.02.2019).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'ia kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse



për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

| NR | Nr. An    | PERSHKRIMI I PUNIMEVE  | NJESIA | SASIA |
|----|-----------|--|--------|-------|
|    |           | <b>A . PUNIME MOBILIMI</b>   |        |       |
|    |           | Mobilimi kati perdhe   |        |       |
| 1  | An-mb-01  | F.V rrafte me MDF per zyra ( material mdf me rimeso lisi e lyer (145cm x 40cm me lartesi 190cm dhe gjeresi 40cm, me ndarje cdo 35 cm, trashesia e elementit 30 mm)                                   | cope   | 3.0   |
| 2  | An-mb-02  | F.V rrafte me MDF per zyra ( material mdf me rimeso lisi e lyer (185cm x 40cm me lartesi 190cm dhe gjeresi 40cm, me ndarje cdo 35 cm, trashesia e elementit 30 mm)                                   | cope   | 1.0   |
| 3  | An-mb-03  | F.V rrafte me MDF per zyra ( material mdf me rimeso lisi e lyer (165cm x 40cm me lartesi 190cm dhe gjeresi 40cm, me ndarje cdo 35 cm, trashesia e elementit 30 mm)                                   | cope   | 1.0   |
| 4  | An-mb-04  | F.V rrafte standarte per dosje, MDF( material mdf me rimeso lisi e lyer (gjeresi 40cm me lartesi 190~222cm)  | ml     | 20.1  |
| 5  | An-mb-05  | F.V Tavoline Receptionsioni ne hyrje   | cope   | 2.0   |
| 6  | An-mb-06  | F.V Tavoline zyre (215cmx80cm, materjal mdf I lyer, me syrtare)  | cope   | 1.0   |
| 7  | An-mb-07  | F.V Tavoline zyre (150cmx60cm, materjal mdf I lyer, me syrtare)  | cope   | 3.0   |
| 8  | An-mb-08  | F.V Tavoline zyre (120cmx60cm, materjal mdf I lyer, me syrtare)  | cope   | 10.0  |
| 9  | An-mb-09  | F.V Kolltuqe pritje per zyra   | cope   | 9.0   |
| 10 | An-mb-10  | F.V Tavolina te ulta mesore per zyra   | cope   | 1.0   |
| 11 | An-mb-11  | F.V Tavolina te ulta per femije, materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje (dimension 60x60cm)  | cope   | 1.0   |
| 12 | An-mb-12  | F.V Tavolina te ulta per femije, materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje (dimension 120x60cm)   | cope   | 5.0   |
| 13 | An-mb-12a | F.V Tavolina te ulta per femije, lartesi dhe konfigurim I modifikueshem per grupmoshate ndryshme, materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje forme e crregullt (65x60cm) | cope   | 7.0   |
| 14 | An-mb-13  | F.V Karrike per femije, materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje (dimension 120x60cm)  | cope   | 40.0  |
| 15 | An-mb-14a | F.V Kolltuk Zyre me Lekure,180cm x 70cm)   | cope   | 1.0   |
| 16 | An-mb-14b | F.V Kolltuk ne ambjentin e pritjes me Lekure, (80cm x 80cm)  | cope   | 1.0   |
| 17 | An-mb-14c | F.V Kolltuk ne ambjentin e pritjes me Lekure, pa mbeshtetse (266cm x 40cm)   | cope   | 3.0   |
| 18 |           |  |        |       |
| 19 | An-mb-15  | F.V Karrike zyresh me rrota, mbeshtetese dhe lartesi e modifikueshme (per drejtoret dhe stafin)  | cope   | 18.0  |
| 20 | An-mb-15a | F.V Tavolina ngrenie per menses, Dru I lyer me pjekje ( 100cmx80cm)  | cope   | 4.0   |
| 21 | An-mb-15b | F.V Tavolina ngrenie per menses, Dru I lyer me pjekje ( 380cmx80cm)  | cope   | 5.0   |
| 22 | An-mb-16  | F.V Karrike ngrenie per menses, Dru I lyer me pjekje   | cope   | 44.0  |
| 23 | An-mb-17  | F.V Rrafte metalike per stivimin e produkteve per kuzhinen (H=2.2m), (ne depon ushqimore)  | ml     | 6.0   |
| 24 | An-mb-18  | F.V Perdre per zyra ( model me flete)  | ml     | 23.0  |
| 25 | An-mb-19  | F.V Veshje e mureve me sfungjere dhe lekure (dhoma e terapise se qetesimit)  | m2     | 32.0  |
| 26 | An        | F.V sinjalistike per PAK ne mure   | cope   | 15.0  |
| 27 | An142     | Boje bikoponente (sinjalistika shirit ne dysHEME)  | m2     | 20.0  |
|    |           |  |        |       |
|    |           | Mobilimi kati i pare   |        |       |
| 28 | An-mb-01  | F.V rrafte me MDF per zyra ( material mdf me rimeso lisi e lyer (145cm x 40cm me lartesi 190cm dhe gjeresi 40cm, me ndarje cdo 35 cm, trashesia e elementit 30 mm)                                   | cope   | 4.0   |
| 29 | An-mb-12a | F.V Tavolina te ulta per femije, lartesi dhe konfigurim I modifikueshem per grupmoshate ndryshme, materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje forme e crregullt (65x60cm) | cope   | 7.0   |
| 30 | An-mb-13  | F.V Karrike per femije, materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje (dimension 120x60cm)  | cope   | 12.0  |
| 31 | An-mb-20  | F.V Karrike, strukture metalike dhe ulese sfungjer e stufe   | cope   | 16.0  |
| 32 | An-mb-20  | F.V Tavolina Druri me gjeometri te crregullt per konfigurime te ndryshme   | cope   | 6.0   |
| 33 | An-mb-19  | F.V Veshje e mureve me sfungjere dhe lekure (dhoma e terapise se qetesimit)  | m2     | 66.0  |
| 34 | An        | F.V sinjalistike per PAK ne mure   | cope   | 6.0   |
| 35 | An142     | Boje bikoponente (sinjalistika shirit ne dysHEME)  | m2     | 12.0  |
|    |           | <b>B . PAJISJE</b>   |        |       |

|   |          |  |      |     |
|---|----------|--|------|-----|
| 1 | An-p-01a | F.V Pajisje per stervitje sportive per femije ( Set Biciklete )  | cope | 2.0 |
| 2 | An-p-01b | F.V Pajisje per stervitje sportive per femije ( Set Step )   | cope | 2.0 |
| 3 | An-p-02a | F.V Frigorifer per depon ushqimore, (75x55cm, h=85cm)  | cope | 3.0 |
| 4 | An-p-02a | F.V Frigorifer banak per kuzhinen (pjesa e sipërme platforme inoks qe lejon pregatitjen e produkteve te gatimit), (60x60cm, h=85cm)  | cope | 2.0 |
| 5 | An-p-04  | F.V Furra per kuzhina me fluks te larte (60x60cm, h=85cm)  | cope | 2.0 |
| 6 | An-p-05  | F.V Pjekese me gaz dhe me energji elektrike per kuzhina me fluks te larte (60x60cm, h=85cm)  | cope | 3.0 |
| 7 | An-p-06  | F.V Kabinete inoksi me syrtare per stivimin e orendive dhe pajisjes te kuzhines, (pjesa e sipërme platforme inoks qe lejon pregatitjen e produkteve te gatimit), (60x60cm, h=85cm) | cope | 4.0 |
| 8 | An-p-07  | F.V Kabinete inoksi me syrtare per stivimin e orendive dhe pajisjes te kuzhines, (pjesa e lavapjate me mishelatore), (120x60cm, h=85cm)  | cope | 1.0 |

### **Përcaktimi i listës së pajisjeve të mobilimit duke hartuar paralelisht dhe pozicionimin e tyre në hapësirat përkatëse**

Duke u mbështetur tek projektet e zbatimit të krijimit të hapsirave, si dhe në kërkesat e personave përgjegjës, u hartua edhe lista e pajisjeve të mobilimit e cila është menduar të ndahet në disa grupime. Në grupimin e parë, atë të karrigeve dhe kolltuqeve përfshihen , karriget-poltrona për vend pune drejtuesi, karriget-poltrona për vend pune specialisti, karrige për tavolinë mbledhjeje, karrige të thjeshta per mence ,karrige per femije, Kolltuqe per ambjete e zyrave dhe per sallën e ndenjes se perfituesve . Në grupimin e dytë, atë të tavolinave, përfshihen tavolinat per zyrat e personelit, tavolina per femijet me dimernsione te ndryshme dhe madhesi te ndryshme per grupmosha te ndryshme prej druri dhe reziztente , tavolina per ngrenie ne mence prej druri te lyera me pjekje dhe rezistente Në grupimin e tretë, atë të rrafteve bëjnë pjesë raftet per zyra me ndarje standarte per mbajtjen e dokumentave . Në grupimin e katërt bëjnë pjesë dy mobiljet e kuzhinës për dhomën e stafit. Në grupin e pestë, bëjnë pjesë recepsionet me një post pune Ndërsa në grupin e fundit, atë të aksesoreve, bëjnë pjesë perdet e dritareve, veshja e mureve me sfyngjer dhe lekure si dhe boje bikoponente per sinjalistike new dysHEME dhe ne mure.

### **Përcaktimi i përmasave optimale të mobiljeve, referuar kjo edhe volumeve ekzistuese të ambienteve si dhe standartet e dimensionimit të hapsiraveve midis tyre**

Referuar standarteve kombëtare të projektimit si dhe normave që rrjedhin nga vendimet apo aktet administrative të sipërpërmendura, si dhe duke ju referuar edhe përmasave të ambienteve që do të mobilohen, është bërë edhe pozicionimi në planimetri i pajisjeve të mobilimit. Nëpërmjet orjentimit të pajisjeve në planimetri, ka dalë i përlllogaritur edhe numri përkatës për secilin lloj. Eshtë marrë parasysh në këtë fazë, që mobiljet duhet të kenë përmasa optimale për të bërë të mundur transportimin e lehtë të tyre, duke shmangur dëmtimet e mundshme. Gjithashtu është patur parasysh që të lihen midis orendive edhe hapësirat optimale, për të bërë të mundur lëvizjen pa vështirësi të stafit.

## **Hartimi i specifikimeve teknike për secilën pajisje mobilimi, duke u përpjekur për të respektuar standartet optimale dhe një cilësi shumë të mirë.**

Duke ndjekur rrjedhen llogjike të projektimit, janë hartuar edhe specifikimet teknike për çdo pajisje. Në vijim janë dhënë të plota këto specifikime, të cilat jo vetëm që përshkruajnë fizikisht pajisjen, por japin edhe përmasat optimale të tyre, referuar vendit të montimit.

### F.Karrige - Poltronë për vend pune drejtuesi:

Kjo karrige duhet të jetë e rrotullueshme, me bazament prej materiali metal i kromuar, me 5 rrota cilësore, me material antizhurmë dhe antigërvishtje.

Ulësja dhe mbështetësja duhet të jenë një trup i pandashëm, me strukturë të pa deformueshme, e mbushur me material amortizues dhe të jetë e mbuluar me tapiceri lëkurë ekologjike, rezistente, antibakterial, i padepërtueshëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. Përmasat e poltronit duhet të jenë jo më të vogla se: Shpinorja 80x50cm dhe ulësja 40x50cm. Lartësia e ulëses së karriges duhet të jetë e rregullueshme nëpërmjet një pistonit ulje-ngritjeje. Shpinorja e karriges duhet të ketë një formë të tillë që të ofrojë qëndrim dhe përshtatje optimale. Ajo duhet të jetë e rregullueshme në këndin e pjerrësisë së mbështetjes. Mbështetëset e krahëve duhet të jenë të përbëra nga strukturë metalike të veshura me material amortizues dhe rezistent ndaj fërkimit.

### F.Karrige për femije :

Material druri, rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje (dimension 120x60)  
Fundi i këmbëve dhe anësoret e tyre duhet të mbuloohen me tapa në mënyrë që të shmangin. Duke pasur parasysh kontigjentin e femijve që do të frekuentojnë këto qender (me aftësi të kufizuara si autok, daun, me zhvillim të vonuar) kërkojmë edhe specifikimet e mesperme që karriget të mos jenë të ashpra dhe të rezistojnë gërvishtjeve të ndryshme

### F.Karrige e thjeshtë :

Karrige e thjeshtë, konforte, e kornizuar me 4 këmbë metalike të palëvizshme me tapa plastike. Ulësja dhe mbështetësja duhet të jenë të veshura me material rezistent, antibakterial, i padepërtueshëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. (pesha 7kg, lartësia e shpinorës jo më e vogël se 82cm, lartësia e ndenjësës jo më e vogël se 45cm, thellësia rreth 43cm, gjerësia rreth 43cm.)

### Kolltuqe :

Poltronë Kolltuqe , konforte, me strukturë solide të veshur me material amortizues. Ulësja dhe mbështetësja duhet të jenë të veshura me material rezistent, antibakterial, i padepërtueshëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. Gjithashtu, poltrona duhet të jetë e pajisur me mbështetëse për krahët. Përmasat duhet të jenë të ndryshme sipas hapësirave që do të mobilohen

### FV Tavoline pune

Tavolina pune duhet të jenë me materail MDF e lyer me 3 sirtare

### F.Tavolinë e vogël mesi

Tavolina me dimensione 80x40x h40 cm, duhet të ketë syprinën me material laminant me bordurë të plastifikuar me trashësi 2.5 cm, dhe strukturë me skelet metalik, tubolar me seksion katror me sipërfaqe të lyer me proces elektrolitik. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirë

### F.V Tavolina te ulta per femije.

F.V Tavolina te ulta per femije ME materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje (dimension 120x60cm), lartesi dhe konfigurim te modifikueshem per grupmosha te ndryshme, materjale druri rezistente ndaj veprimeve mekanike, te lyera me pjekje forme e crregullt (65x60cm)

### FV Tavolina ngrenie per menses,

Dru I lyer me pjekje ( 100cmx80cm)

### FV Mobilje kuzhine me lavapjate

Mobilja me lavapjatë duhet ndërtuar si një strukturë më vete, me përmasa jo më të vogla se (60x60xh85cm), me material laminant me trashësi jo më të vogël se 1.6 cm dhe bordurë të plastifikuar.

Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant me trashësi 0.3 cm. Syprina duhet të jetë me material rezistues ndaj lagështirës të cilësisë së lartë laminat i plastifikuar (ABS) dhe trashësi 4-5 cm, i cili siguron qëndrueshmëri të gjatë. Mbi këtë syprinë është i inkorporuar lavapjati me material inoksi me dy gropa dhe një vend për kullimin e enëve të kuzhinës. Në lavapjatë duhet të jetë montuar dhe grupi i miksimit të ujit. Poshtë lavapjatis, duhet të ketë një dollap me dy kanate me doreze metalike ngjyre gri mat, ku në njërin prej tyre duhet të ketë inkorporuar koshin e mbeturinave me material plastik me kapak të lëvizshëm. Struktura duhet të ketë këmbë plastike me lartësi 10 cm, të regjistrueshme, dhe të mbuluara me fashetë lineare.

### F.V Mobilje kuzhine pa lavapjatë

Mobilja pa lavapjatë duhet ndërtuar si një strukturë më vete, me përmasa jo më të vogla se (60x60xh85cm), me material laminant me trashësi jo më të vogël se 1.6 cm dhe bordurë të plastifikuar.

Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant me trashësi 0.3 cm. Syprina duhet të jetë me material rezistues ndaj lagështirës të cilësisë së lartë laminat i plastifikuar (ABS) dhe trashësi 4-5 cm, i cili siguron qëndrueshmëri të gjatë. Mobilja, duhet të ketë një dollap me dy kanate me material laminant, me bordurë të plastifikuar, me doreze metalike ngjyre gri mat, të ndarë horizontalisht në dy hapsira të barabarta. Struktura duhet të ketë katër këmbë plastike me lartësi 10 cm, të regjistrueshme, dhe të mbuluara me fashetë lineare.

### F.V Veshje e mureve me sfungjere dhe lekure (dhoma e terapise se qetesimit)

Femijet që do të frekuentojnë qendrën komunitare me aftësi të kufizuara janë femije me probleme shumë specifike, që herë pas herë janë të irrituar dhe me probleme shëndetsore specifike.

Per këto arsye dhomen e terapisë së qetesimit do të vishen me sfungjere dhe lekure që këto femije mos të lendojnë veten kur kanë probleme shëndetsore

### FV Pajisjet e guzhines

Pajisjet e guzhinës (sobe, furre, frigorifere, frigorifer banak) do të jenë me efikasitet energjie AAA

Sinjalistika nuk do të mungojë në ambientet e institucionit. Kjo sinjalistike do të vendoset nëpër mure apo dhe me shiritë në dyshe me bojë bikoponente

Relacioni i hartuar nga Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike dhe përlogaritjes së fondit limit, i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr. 33, datë 06.04.2023 përmban informacionin specifik mbi bazën e të cilit do të ofertohej nga operatorët ekonomikë. Këto dokumenta janë pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe përmbajnë qëllimin e objektit të prokurimit, grafikun e ekzekutimit, specifikimet teknikë të mallrave dhe sasinë të tyre. Hartimi dhe argumentimi i specifikimeve teknike është bërë nga komisioni, duke

u bazuarnë nenin 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 15, pika 3/b, të VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Specifikimetteknike, për kontratën objekt prokurimi shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për furnizimin e mobiljeve dhe orendive të zyrës, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrëndhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36,të LPP, si dhe nenit 40 të VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standardtë kërkuar, ku çdo referencë do të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

Maris Jorgji  
Eliona Mehmeti  
Gresilda Malo





